

PROJEKTVENDIM

Nr. __, datë __.2026

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 895,
DATË 21.12.2016 “PËR KRITERET E ECURISË DHE FITIMIT TË GRADAVE,
NJËSIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË,
PARAQITJEN, FORMËN DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TË GRADAVE TË
SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr. 152, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozim të Ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 895, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 të vendimit dhe në lidhjen nr. 2, të parashikuar në pikën 8, të vendimit, fjalët “Inspektor Zjarrfikës” zëvendësohen me fjalët “Nënkomisar Zjarrfikës”, fjalët “Kryeinspektor Zjarrfikës” zëvendësohen me “Komisar Zjarrfikës”, fjalët “Komisar Zjarrfikës” zëvendësohen me “Kryekomisar Zjarrfikës”.
2. Lidhja nr. 1, “Tabela e ekuivalentimit të gradave dhe e funksioneve korresponduese për çdo gradë”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me titull “Tabela e njësimin të funksioneve korresponduese për çdo gradë”, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**TABELA E NJËSIMIT TË FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR ÇDO
GRADE**

GRADAT	FUNKSIONET
NIVELI MADHOR	
Drejtues i lartë zjarrfikës	Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.
NIVELI I LARTË	
Drejtues i parë zjarrfikës	Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.
Drejtues zjarrfikës	Drejtor i Shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, Përgjegjës Sektori i Shërbimit të MZSH-së në nivel qendror.
NIVELI I MESËM	
Kryekomisar zjarrfikës	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së, Instruktor në Qendrën e Trajnimit Zjarrfikës, Shef Sektori Ndërhurje në Drejtorinë/Sektorin në nivel vendor të Shërbimit të MZSH-së.
Komisar zjarrfikës	Shef sektori në shërbimin e MZSH-së në bashki jo qendër qarku, Drejtues Ndërhurje & Shuarjen e Zjarreve në bashkitë qendër qarku dhe jo qendër qarku, Instruktor/trajnues në Qendrën e Trajnimit Zjarrfikës, Instruktor trajnimi në nivel vendor niveli i mesëm, Inspektor parandalimi.
Nënkomisar zjarrfikës	Punonjësi i shërbimit të MZSH-së në nivelin e mesëm, në momentin e rekrutimit, emërimit, dhe pasi përfundon me sukses testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në Qendrë Kombëtare të Trajnimit Zjarrfikës në DPMZSH-së.
NIVELI BAZË	
Kryezjarrfikës	Komandant Stacioni të MZSH-së, Përgjegjës Shërbimi 12 ose 24 orësh, Instruktor stërvitje niveli bazë, Punonjës në sallën operuese.
Zjarrfikës	Luftues, Shpëtues, Drejtues automjeti, Mekanik.
Asistent zjarrfikës	Punonjësi i shërbimit të MZSH-së në nivelin bazë, në momentin e rekrutimit dhe pasi përfundon me sukses testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në Qendrën Kombëtare të Trajnimit Zjarrfikës në DPMZSH.